



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 40 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 të Statutit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, në ndërlidhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më **15.7.2026** merr këtë

VENDIM

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE PËR REKRUTIMIN E DREJTORËVE
DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE
AFTËSUESE NË KRYEQYTET**

Neni 1

Qëllimi

Përmes këtij vendimi, Kuvendi i Kryeqytetit cakton anëtarët e komisioneve profesionale për rekrutimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Kryeqytet.

Neni 2

Përbërja e Komisioneve

Komisionet e rekrutimit për secilin institucion edukativo-arsimor dhe aftësues për parashkollor, nivelin e fillor dhe të mesëm të ulët, nivelin e mesëm të lartë dhe shkollave profesionale/IAAP-ve do të kenë përbërjen e rregullt prej tre (3) anëtarëve dhe dy (2) vëzhguesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

Përbërja e komisioneve është si vijon:

- **Dy (2) përfaqësues nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), të rekomanduar nga DKA, si në vijim:**
 1. **znj. Fitnete Tutuli – Zyrtare e lartë për arsim të mesëm të lartë në Drejtorinë Komunale të Arsimit;**
 2. **z. Isak Bregaj – Drejtor me performancë të lartë; në rast të mungesës së tij, anëtar i komisionit do të jetë z. Egzon Gashi – Ekspert i Arsimit.**

- Një (1) përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), i caktuar nga MASHTI.
- Dy (2) përfaqësues nga Këshilli i Prindërve dhe një mësimdhës, të cilët nominohen nga Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH) – në cilësinë e vëzhguesve.

Neni 3

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Komisionet e emëruara sipas këtij vendimi kanë për detyrë të udhëheqin tërë procesin e rekrutimit, duke përfshirë:

1. Shqyrtimin dhe verifikimin e aplikacioneve të kandidatëve;
2. Hartimin e listave të ngushta të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara;
3. Organizimin dhe zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistave me gojë;
4. Rekomandimin e kandidatëve më të suksesshëm te Kryetari i Kryeqytetit për emërim.

Neni 4

Kompensimi

Anëtarët e komisioneve kanë të drejtë në kompensim për punën e kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mjetet buxhetore të planifikuara nga Kryeqyteti për këtë qëllim.

Neni 5

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Kryetari i Kryeqytetit.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-106199/26, më 16.7.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Ky propozim-vendim i paraqitet Kuvendit të Kryeqytetit për shqyrtim dhe miratim, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor dhe plotësimit të pozitave udhëheqëse në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese, të cilat aktualisht menaxhohen nga ushtrues detyre ose kanë kontrata të skaduara. Procesi i rekrutimit do të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencë, meritokraci dhe mundësi monitorimi nga shoqëria civile dhe mediat.